

02 Nr. Br. 400/01-11968/24
07.06. 20 24
Dragash - Dragas



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIC OF KOSOVA-REPUBLIKA KOSOVA
KUVENDI I KOMUNËS NË DRAGASH
MUNICIPAL OF ASSEMBLY IN DRAGASH
SKUPSTINA OPSTINE DRAGAS



NJOFTIM

Komuna e Dragashit është në proces të organizimit të dëgjimeve buxhetore me qytetarë për Kornizën Afatmesme Buxhetor (KAB) 2025-2027. Me qëllim të sigurimit të gjithëpërfshirjes, me theks në pjesëmarrjen e grupeve të ndryshme qytetare, Komuna e Dragashit ka përpiluar dhe publikuar Kalendarin e organizimit të dëgjimeve buxhetore për Kornizën Afatmesme Buxhetor (KAB) 2025-2027 . Për këtë qëllim, ekzekutivi i Komunës gjatë muajit qershor ka paraparë të organizohen tri (3) dëgjime buxhetore me qytetarë dhe grupe të ndryshme të interesit, duke përfshirë OJQ, biznese, fermerë, komunitete joshumicë etj.

Andaj, me qëllim të angazhimit aktiv dhe planifikimit të buxhetit të Komunës bazuar në kërkesat dhe nevojat e qytetarëve, Komuna e Dragashit ju fton në:

Dëgjimin Buxhetor me drejtorë të shkollave, pedagogë, punëtorë arsimorë dhe punëtorë shëndetësorë

KOHA: 14 Qershor 2024, Ora 11:00

VENDI: Salla e Asamblesë Komunale në Dragash

Kalendarin e organizimit të dëgjimeve buxhetore mund ta gjeni në këtë link: <https://kk.rks-gov.net/dragash/wp-content/uploads/sites/12/2024/05/Kalendari-i-degjimeve-buxhetore-1.pdf>

Informacionet për projekt-buxhetin dhe dokumentet tjera buxhetore mund t'i gjeni në këto linqe:

<https://kk.rks-gov.net/dragash/category/takimet-dhe-degjimet-publike-buxhetore/draft-buxheti/>

<https://kk.rks-gov.net/dragash/category/financa/>

Nëse nuk keni mundësi për të marrë pjesë me prezencë fizike në këtë takim, kërkesat, komentet dhe sugjerimet për Kornizën Afatmesme Buxhetor (KAB) 2025-2027 mund t'i dërgoni në këto email adresa: gamil.kolloni@rks-gov.net, burim.aliu@rks-gov.net dhe fari.kolloni@rks-gov.net

Me respekt,

Zyra për Informim – Komuna e Dragashit